

PKR.nr.1060/13

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**, në përbërje nga trupi gjykues prej tre gjyqtarëve profesionistë, përkatësisht gjyqtari Naser Foniqi – kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtarët Hamdi Ibrahimimi e Isuf Makolli, anëtarë të trupit gjykues, me procesmbajtësen Sevdije Breznica, në çështjen penale të të akuzuarit D.R, për shkak të veprave penale Grabitje, nga neni 329, par. 3, lidhur me nenin 31, të KPRK dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374, par. 1, të KPRK, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP.nr.965/13, të datës 22.11.2013, në shqyrtimin gjyqësor, të hapur për publikun, të mbajtur më datat: 05.12.2017; 26.02.2018 dhe 04.04.2018, në të cilin ishin të pranishëm: Prokurori i shtetit Ilaz Beqiri; i akuzuari D.R, me mbrojtësen e tij av. A.K., me autorizim dhe e dëmtuara – dëshmitarja Sh.S., pas shqyrtimit gjyqësor, me datë 05.04.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari D.R**, i biri i S.1 dhe S.2, e vajzërisë Y., i lindur me ..., në Gj., tani me banim në P., rr. "O.B.", nr. ..., me numër personal ..., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 364, par. 1 nënpar. 1.3, të KPPK,

**LIROHET NGA AKUZA**

1. **S e p s e**: me datë 16.09.2013, rreth orës 21:40, në Prishtinë, në furrën e bukës "Sh.", në rrugën "B.B.", në bazë të marrëveshjes paraprake me personin deri me tani të panjohur për prokurorinë, me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme, në mënyrë të kundërligjshme dhe nën kërcënimin e armëve, kanë grabitur nga tani e dëmtuara Sh.S.-punëtore e kësaj furre, shumën prej 170 euro, pastaj kanë kërkuar para të tjera nga tani e dëmtuara, e kur e njëjta duke bërëtitur ka deklaruar se nuk ka para, të pandehurit me shpejtësi kanë ikur në drejtim të panjohur, ndërsa të dëmtuarës i kanë shkaktuar frikë të madhe dhe dëm material,-
  - Pasi që, nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale Grabitje, nga neni 329, par. 3, lidhur me nenin 31, të KPRK.
2. **S e p s e**: nga data e pacaktuar e deri 16.09.2013, pa autorizim ka mbajtur revolen e tipit të pa njohur, të cilën e ka poseduar me rastin e kryerjes së veprës penale si në dispozitivin I, të aktakuzës,-
  - Pasi që, nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374, par. 1, të KPRK.

- **E dëmtuara Sh. (R.) S.**, nga P., lagja “V.”, rr. “Sh.K.”, nr. ..., për realizimin e kërkesës pasurore udhëzohet në kontest civil.
- Shpenzimet gjyqësore, bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

## A R S Y E T I M I

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën PP.nr.965/13, të datës 22.11.2013, ka akuzuar të pandehurin D.R, për shkak të veprave penale Grabitje, nga neni 329, par. 3, lidhur me nenin 31, të KPRK dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374, par. 1, të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor, të datës 05.12.2017, pas leximit të aktakuzës, i pandehuri D.R, ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe është deklaruar i pa fajshëm për veprat penale për të cilat është akuzuar nga Prokuroria.

Në fjalën hyrëse Prokurori i shtetit, ka deklaruar se në këtë çështje penale ka zhvilluar hetimet dhe siguruar provat, se i pandehuri i ka kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë, dhe kjo gjendje faktike do të vërtetohet nga deklarata e të dëmtuarës - dëshmitares Sh.S., e cila ka përshkruar veprimet inkriminuese të të pandehurit si dhe dëmi të cilës i është shkaktuar, ndërsa në fjalën përfundimtare, Prokurori i shtetit ka deklaruar, se mbetet pranë aktakuzës dhe i propozon gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, pasi që gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprat penale që i vihen në barrë, në kohë, vend dhe mënyrë siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, dhe se gjendja e tillë faktike është vërtetuar nga deklarata e të dëmtuarës - dëshmitares Sh., e cila gjatë hetimeve ka deklaruar se është e sigurt se personi D.R, është ai i cili ka marr pjesë në grabitjen, viktimë e së cilës ka qenë dëshmitarja, dhe e njëjta në shqyrtim gjyqësor është deklaruar se tani mendon se është e sigurve 50 për qind se është tani i akuzuari D.R, ai që ka kryer grabitjen.

E dëmtuara Sh.S., në fjalën hyrëse ka deklaruar se ndihet e dëmtuar në këtë rast, kërkon kompensim dëmi, por vlerën e tij tani për tani nuk është e gatshme ta përcaktoi.

Mbrojtësja e të akuzuarit, av. A.K., në fjalën hyrëse ka deklaruar se përshkrimi dhe kualifikimi të veprës penale të përshkruar në dispozitivin 1 të aktakuzës, nuk mund të qëndroi për arsye se KPRK, ka përcaktuar se kjo vepër penale kryhet në grup, ndërsa sipas nenit 120 të këtij kodi, me grup njerëzish kuptojmë tre apo më shumë persona, duke pasur parasysh se prokurori e ka akuzuar të mbrojturin e saj dhe një person të panjohur. Pastaj, mbrojtësja ka shtuar se me këtë aktakuzë nuk mund të provohet fajësia e klientit të saj, me arsyetim se aktakuza nuk përmban prova dhe fakte që arsyetojnë dyshimin e bazuar mirë, duke i propozuar gjykatës që për zbardhjen e kësaj çështje të nxjerrën telefonatat në kohën kur pretendohet se është kryer vepra penale, me qëllim të zbardhjes së alibisë për klientin e saj. Ndërsa, në fjalën përfundimtare, mbrojtësja ka theksuar se prokuroria me asnjë provë të vetme nuk ka mundur të vërtetoj tezën e aktakuzës, duke shtuar se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor e dëmtuara-dëshmitarja S., tri herë ka dhënë deklaratë lidhur me ngjarjen kritike, por e njëjta asnjëherë nuk ka mundur që saktë të identifikoj se i mbrojturi i saj me të vërtetë është personi i cili pretendohet se ka

marrë pjesë natën kritike dhe se kjo gjë është dëshmuar edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, kur dëshmitarja ka deklaruar se lidhur me identifikimin e personit, është marr dy herë radhazi nga policia, ku në herën e parë policia ka dështuar të përpiloi procesverbal lidhur me identifikimin e personave, të bazuar në nenin 257 të KPPK, dhe e cila është marrë me

shkelje të dispozitave të KPPK, e që do të duhej të shpallej provë e papranueshme nga gjykata, me arsyetim se neni 120 i KPPK, përcakton se gjithmonë para se të bëhet identifikimi i personave apo sendeve, nga dëshmitari kërkohet të tregoi tiparet dalluese të personit, prandaj mbrojtja konsideron se identifikimi i ofruar nga ana e policisë të dëmtuarës është provë e papranueshme. Po ashtu, mbrojtësja ka thënë se dëshmitarja në tërë deklaratën e saj të dhënë para trupit gjykues ka qenë kontradiktore, dhe asnjëherë nuk ka qenë e përqendruar apo e saktësuar se është me të vërtetë i njëjti person, prandaj në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar gjatë procedurës, mbrojtësja ka thënë se konsideron se nuk ka prova të mjaftueshme për të fajësuar ose dënuar dikë dhe në mungesë të provave, i ka propozuar gjykatës të nxjerr aktgjykim lirues në pajtim me nenin 364, par. 1, nëpar.1.3, të KPPK.

I akuzuari D.R, në fjalën e tij përfundimtare, ka theksuar se e mbështet në tërësi fjalën e mbrojtëses së tij.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, janë dëgjuar e dëmtuara – dëshmitarja dhe janë administruar provat materiale, të propozuara nga prokuroria në aktakuzë dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të paraqitura si në vijim:

- Dëshmia e të dëmtuarës- dëshmitares Sh.S., e cila ka deklaruar se i kujtohet data 16.09.2013, kur ka qenë në orar të punës në furrën “Sh.”, në rr. “B.B.”, te H. i D., ku ka punuar shitëse, e ku zakonisht ka punuar pas dite prej orës 14-22, duke shtuar se në datën si më lart, ka qenë vet në furrë, kur në ora 21:40m, derisa ka qenë duke pastruar objektin-frizat, në furrë kanë hyrë dy persona me armë në dorë, dhe se ajo në atë moment ka menduar se është lojë, e pastaj ata dy persona i kanë thënë “qiti paret dhe mos bën zë”, ndërsa tani e dëmtuara ka dalë në anën e përparme afër kasës, i ka tërheqë paratë, përkatësisht pazarin ditor në shumë prej 170 euro. Po ashtu, e dëmtuara- dëshmitarja ka thënë se drejt belit të saj janë drejtuar armët, të cilat kanë qenë ngjyrë e zezë dhe e di se kanë qenë revole, ndërsa personat nuk kanë qenë të maskuar, përkatësisht njëri ka qenë zeshkan kurse tjetri ka qenë blond, në moshë prej 18-20 vjeç dhe se të njëjtit kanë pasur dorëza dhe se kur kanë ikur, ata kanë shkuar në drejtim të panjohur, ndërsa ajo-e dëmtuara ka dalë nga furra e shokuar, është ofruar në marketin aty afër, dhe iu ka treguar për ngjarjen, e në atë moment i ka rënë të fikët, derisa kanë ardhur pronaret e furrës dhe policia. E dëmtuara – dëshmitarja ka thënë se e di se në kasë kanë qenë 170 euro, për shkak se pronari e ka bërë barazimin dhe i ka thënë se kjo shumë të është vjedhur, pastaj, e njëjta ka theksuar se **në momentin kur është kryer vepra penale nuk ka qenë në gjendje t’i identifikoi fytyrat e dy personave, ndërsa kur e kanë thirrë në polici brenda dy ditësh, atëherë e ka identifikuar njërin nga personat, duke shtuar se në polici janë paraqitur disa persona në një sallë, në mes ka qenë një xham e përmes tij ka identifikuar personin, të cilit emrin nuk ja ka ditur por e ka identifikuar si fytyrë, duke shtuar se atëherë ka qenë 50% e sigurt se tani i akuzuari ka hyrë në furrë atë natë dhe se ditën e parë kur ka bërë identifikim, asaj i janë paraqitur dy persona të moshës përafërsisht të njëjtë.**
- Procesverbali i identifikimit, numër 2013-AC-1703, i datës 06.09.2013 sipas të cilit është vërtetuar se e dëmtuara ka bërë identifikimin e personit i cili ka kryer veprën penale.
- foto dokumentacioni në të cilin shihet zbatimi i procedurës së identifikimit të personit të akuzuar.

I akuzuari D.R, në mbrojtjen e tij ka deklaruar se e di ku gjendet furra “Sh.”, pasi e njëjta ndodhet në lagjen e tij, përkatësisht është larg shtëpisë së tij rreth 300-400 metra dhe të njëjtën furrë e ka frekuentuar në kohën për të cilën akuzohet, duke shtuar se aty ka punuar një mashkull rreth 35-40 vjeç dhe se nuk ka vërejtur ndonjëherë ndonjë punëtorë të gjinisë femër. Po ashtu, i akuzuari ka thënë se tani nuk i kujtohet ku ka qenë në atë kohë por ka shtuar se e di se pas dy javësh pasi ka ndodhur rasti e ka ndaluar policia, të cilët ka thënë se i ka pyetur se për çka është fjala, e të cilët i kanë thënë “Jemi duke të kërkuar që dy javë” e pastaj i kanë treguar për rastin e furrës që është plaçkitur dhe se i njëjti atyre iu kishte thënë “jeni gabim”, duke pasur parasysh se ka qenë i pafajshëm, duke shtuar se të dëmtuarën nuk e ka njohur më përpara, përveç kur e ka parë në gjykatë me datë 05.12.2017. Pastaj, i akuzuari ka thënë se nuk ka bartur armë në vitin 2013 dhe beson se në kohën kur ka ndodhur ky rast, ai ka qenë në shkollën e mesme dhe është marrë herë pas here me muzikë.

Pas vlerësimit të dëshmisë së dëshmitareve, administrimit të provave materiale dhe mbrojtjes së të akuzuarit, gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata e vërtetoi nga:

- Dëshmia e të dëmtuarës- dëshmitares Sh.S., e cila gjatë dhënies së dëshmisë së saj nuk ka qenë e sigurt kur ka paraqitur ngjarjen dhe tani të akuzuarin, duke thënë se edhe atëherë edhe tani është 50 për qind e sigurt se tani i akuzuari D.R, ka qenë personi që natën kritike i ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar. Po ashtu, gjykata ka vlerësuar edhe thëniet e dëshmitares se në momentin kur është kryer vepra penale nuk ka qenë në gjendje t’i identifikoi fytyrat e dy personave, duke pasur parasysh se në fillim të dëshmisë së saj, e njëjta ka deklaruar se e njeh të akuzuarin D. pasi që i njëjti edhe para rastit është këta persona kanë qenë në furrë, kanë folur fjalë banale, se pastaj ajo iu kishte thënë “manjaka”, e po ashtu edhe një kalimtar i rastit, iu kishte bërë titur dhe ata kishin dalë.
- Edhe sa i përket procesverbalit të identifikimit, numër 2013-AC-1703, i datës 06.09.2013 sipas të cilit është vërtetuar se e dëmtuara ka bërë identifikimin e personit i cili ka kryer veprën penale, gjykata ka vlerësuar thëniet e të dëmtuarës - dëshmitares Sh.S., se nuk ka qenë më e sigurt se 50 për qind se tani i akuzuari D.R, ka qenë personi që natën kritike i ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar, gjykata i ka marrë dhe vlerësuar në favor të akuzuarit, duke u bazuar në dispozitën e nenit 3, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës dhe mëdyshjet si më lart i ka interpretuar në favor të akuzuarit.
- Sipas foto dokumentacionit i cili gjendet në shkresat e lëndës, me të cilin është paraqitur zbatimi i procedurës së identifikimit të personit të akuzuar, gjykata ka vlerësuar se ky identifikim është bërë ashtu siç e parashohin dispozitat e nenit 120 të KPPK, pasi që para identifikimit, e dëmtuara - dëshmitarja Sh.S., ka bërë përshkrimin e përafërt të personave të dyshuar.

Sa i përket kësaj çështje penale, trupi gjykues ka vlerësuar dhe analizuar dëshminë e të dëmtuarës - dëshmitares Sh.S. dhe provat materiale të paraqitura si më lart, por me asnjërën nga këto prova nuk është arritur të vërtetohet se i akuzuari D.R, me datë me datë 16.09.2013, rreth orës 21:40, në vendin dhe mënyrën siç është paraqitur në dispozitivin e aktakuzës.

Lidhur me pretendimet e Prokurorit të shtetit, se i pandehuri D.R, ka kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, trupi gjykues vlerësoi se me asnjë provë nuk

është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprat penale Grabitje, nga neni 329, par. 3, lidhur me nenin 31, të KPRK dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374, par. 1, të KPRK, andaj të njëjtin edhe e liroi nga akuza.

Ndërsa, lidhur me mëdyshjet e tani të dëmtuarës – dëshmitares Sh.S., se atëherë ka qenë 50 për qind e sigurt se tani i akuzuari ka hyrë në furrë atë natë, gjykata është bazuar në dispozitën e nenit 3, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, kur mëdyshjet si më lart i ka interpretuar në favor të akuzuarit dhe të drejtave të tij, të parapara me KPPK dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishëm, në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPK, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 454, par.1 të KPPK.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 364, par.1, nënpar. 1.3, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 12.04.2018.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/ DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA  
PKR.nr.1060/13, datë 05.04.2018.

Sekretare juridike  
Sevdije Breznica

---

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari  
Naser Foniqi

---

#### **UDHËZIMI JURIDIK:**

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, me seli në Prishtinë.